

Lushnja/ Interesim i madh per ndeshjen ndaj Tiranes

nga AlbaniaSoccer

E premte, 29 Nentor 2013 23:39



Pritet me shume interes ndeshja qe do te zhvillohet ne stadiumin "Roza Haxhi ", te qytetit e Lushnjes, midis ekpit vendas dhe Tiranes. Mesohet se ka te ngjare qe shkallet e stadimit do te jene te mbushur me sportdashes vendas dhe te zonave per rreth qytetit. Vetem diten e djeshme sipas burimeve prane klubit, mesohet se jane shitur ne kohe rekord rreth 4000 biletat. Nderkohe, Keshilli Bashkiak i qytetit te Lushnjes ka marre vendimin se ne rast fitoreje futbollistet do te marrin nje premio rreth 15000 leke (te reja). Ne kampin lushnjtar ka optimizem qe ndeshja ndaj Tiranes do te kalohet me sukses. Skuadra e Lushnjes ne ndeshjen ndaj Tiranes nuk do te kete sherbimet e tre futbollisteve kryesore. Behet fjale per fantazistin Celai cili eshte i demtuar dhe mbrojtesit Byzhyti e Cimili qe do te mungojne per shkak kartonash.